



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Planifikimit Strategjik
Periudha raportuese	Prill, 2023
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Mimoza Sylejmani Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik

PROJEKTET :

- Pjesa e planifikimit të PZHK-së, në përfundim e sipër;
- Përditësimi i dokumentit të PZHK-së;
- Bashkërendimi i PZHU-së në GIS me Pdf;
- Përditësimi i rrjetit rrugor të fshatrave, për nevoja të HZ-së;
- Integrimi i kulturës së parcelës në file-in kryesor të parcelave;
- Piketimi i ankesave dhe kërkesave nga qytetarët në vazhdimësi;
- Editimi-adaptimi i aksit në të gjitha zonat rurale të komunës së Prishtinës (për HZ-në);
- Klasifikimi kadastral i përçojave apo telekomunikimeve;
- Ndarja e izohipseve për zonën ekonomike;
- Lidhja e GIS-it me burime tjera, për emërtime të rrugëve (akseve) në pjesën më të madhe të zonës urbane;
- Krijimi i ikonave sipas NTPH-së, për prezantimin e hartave;
- Finalizimi i hartës, për lokacionet e qoshqeve në qytet;
- Organizimi i katit 1 dhe 2 të objektit të ri të Komunës;
- Paramasa për kontratën kornizë, për oborret e QMF-ve, propozim për modelet e kubzeve;
- Angazhimi për përzgjedhjen e inventarit për zyrën e medieve;
- Përfundimi i paramasës për kontratën kornizë për rregullimin e oborreve të QMF-ve;
- Përfundimi i projektit konceptual për riorganizimin e hapësirave të punës në objektin e ri të Komunës.

AKTIVITETET:

- Gjatë muajit prill 2023, në Sektorin e planifikimit janë trajtuar gjithsej 39 lëndë;
- Informimi i palëve për kriteret e planeve, në ditët e caktuara për punë me palë;
- Janë zhvilluar takime me grupin punues për hartimin e PRRH-së, të lagjes “Kalabria”;
- Është formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe komenteve gjatë konsultës publike për bllokun “D2”, lagja “Arbëria 3”;
- Është miratuar në Kuvendin e Komunës Vendimi për harmonizimin e bllokut “D2”.

- **TAKIMET:**

- Takim me nënkryetarin, për çështjen e stacioneve të biçikletave;
- Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Shëndetësisë, për informim lidhur me paramasat për oborret e QMF-ve;
- Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Administratës, për realizimin e projektit për zyrat e medieve;
- Takim me grupin punues, për hartimin e zgjidhjes urbane për Kampusin sportiv;
- Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, për fëmijët në situatë ruge;
- Takim me nënkryetarin, dorëzimi i hartës me lokacionet e stacioneve të biçikletave;
- Takim me përfaqësues të ndërmarrjes “Hortikultura”, për projektin dhe mbikëqyrjen e rigjenerimit të hapësirës për aktivitetin me rastin e Ditës së Tokës, në rrugën “Hajdar Dushi”;
- Takime të rregullta me grupin punues për hartimin dhe kompletimin e PRRH-së “Kalabria”.

VIZITAT NË TERREN:

- **Vizitë në terren për rregullimin e hapësirës në sheshin “Nëna Terezë”;**
- **Vizitë në ambulancë në Bardhosh, matjet e hapësirës për projektimin e laboratorit.**

Prill, 2023